

FATMIRA RAMA

### ASPEKTE TË LUFTËS POLITIKE NË DIASPORË NË VITET E MONARKISË\*

Pak a shumë është krijuar një mendim i përgjithshëm në historiografinë shqiptare dhe atë të huaj se, shpallja e Monarkisë, për shumë faktorë, kaloi qetë dhe pa shumë emocione<sup>1</sup>. Për më tepër kjo situatë do të manifestohej në diasporën e re shqiptare, e shtrirë pothuajse në të gjitha vendet e Ballkanit, në shumë shtete të tjera të Evropës, në SHBA, Amerikën Latine, në Australi e vendet arabe. Lufta e përditshme për mbijetesë, në merak e nevojë për lidhje të vazhdueshme me vendin amë, rritja graduale e vëmendjes së shtetit shqiptar ndaj diasporës etj., çuan nga gjysma e dytë e viteve '20 dhe në vitet 30' të shekullit XX, gati në një ekuilibër konstant të diasporës me shtetin shqiptar. Shpallja e monarkisë në përgjithësi u prit diku me entuziazëm, diku me apati dhe diku me ftohtësi. Pothuajse të gjitha organizatat me karakter kombëtar, krahinor, fetar, mirëbërës, kulturor etj. u kujdesën që në programet e tyre të shprehnin kërkesa për qëndrime jo politike, për ruajtjen e traditave e të gjuhës amtare, për ndihmë e bashkëveprim midis emigrantëve, për veprimtari në dobi të konsolidimit të shtetit shqiptar etj.

Por sigurisht që tabloja nuk ishte rozë. Grupimet politike kundërzogiste në emigracion "Komiteti i Çlirimit Nacional" (KÇN), "Bashkimi Kombëtar", ndërkohë me seli në Vjenë, Lidhja e Emigrantëve në Jugosllavi, disa grupime të vogla në Greqi, Turqi, SHBA, Francë etj., në vijim të programeve të mëparshme, kundërshtuan shpalljen e Monarkisë deri në Lidhjen e Kombeve dhe në programet e tyre u shprehën për rrëzimin e saj dhe për një Republikë Shqiptare<sup>2</sup>. Ata patën ithtarët e tyre kudo në diasporë, sidomos në vende me një traditë demokratike e republikane. Në linjën e Lëvizjes së Qershorit, u kërkuan

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: "Monarkia Shqiptare, 1928-1939", organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

<sup>1</sup> Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Toena", 1996, f.164.

<sup>2</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi 98, viti 1925, dos. 52, fl.1; *po aty*, Fondi 848, viti 1935, dos. 42, fl.1; *po aty*, Fondi 847, viti 1927, dos. 41, fl.1.

prej tyre reforma rrënjësore në Shqipëri, largimi nga skena politike dhe shtetërore e elementeve konservatorë, të quajtur "bejlerë dhe efendilerë", standarte perëndimore në legjislacion, administratë, kulturë, duke qëndruar në pozita republikane, duke kërkuar rrëzimin me çdo kusht të qeverisë aktuale në Shqipëri.

Në vazhdë të debatit të ashpër politik në emigracion gjatë viteve 1925-1928, çka do të kërkonte studime më komplekse, në disa organizata të mëdha kombëtare në emigracion si: në SHBA, Rumani etj., përplasja politike vazhdoi edhe në vitet e Monarkisë. Kjo u manifestua në mënyrën më spektakolare në Federatën e famshme "Vatra", në SHBA, që u zhyt në një krizë të thellë disavjeçare, pasojë dhe e influencave politike të qeverisë shqiptare, të politizimit të skajshëm dhe përpjekjeve për instrumentalizimin e saj. Pikërisht ky është qëllimi që po ndalemi paksa këtu, në rrjedhë dhe të referimeve e shkrimeve të mëparshme, çka na lejon të kuptojmë më mirë atmosferën politike në rrethet aktive të diasporës, edhe në kolonitë e tjera shqiptare<sup>3</sup>.

Federata "Vatra" mbështeti pa kushte si Republikën, ashtu dhe Monarkinë shqiptare dhe Mbretin Zogu I. Madje në Kanunoren e re të saj, në nëntor 1926, sipas neneve 6,7,8,9,10 ishte vendosur të përjashtoheshin të gjithë kundërshtarët politikë, që kërkonin përmbysjen e "Guvernës me mjete revolucionare", që kishin marrëdhënie ose përkrahnin revolucionarët (emigrantët politikë), që kundërshtonin kurdoherë etj. Këto nene, që vazhduan të mbeteshin në fuqi për vite me radhë, shkaktuan pakënaqësi në radhët e atyre që mendonin ndryshe, të quajtur kundërshtarë, të cilët e quajtën Rregulloren si "autokratike" dhe që "shkelte principet demokratike mbi të cilat ishte themeluar kjo organizatë".

Zbatimi i saj e dëmtoi rëndë atë. I shoqëruar me një propagandë të ashpër të gazetës "Dielli" ndaj kundërshtarëve, të etiketuar armiq, bëri që të përjashtoheshin shumë anëtarë të "Vatrës", të largoheshin shumë të tjerë, të mbylleshin degë të tëra. Për më tepër, lufta politike u ndez, me krijimin në Boston në tetor 1930 të Federatës "Shoqëria Botonjëse Shqiptare" (Albanian Publishing Association), APA, që botonte gazetën "Republika", (1930-1932), me drejtues Fan Nolin. Edhe pas tërheqjes së tij nga politika aktive, me ardhjen përfundimtare në SHBA më 1932, mbylljen e gazetës "Republika", të dhënat flasin për disa shoqëri të tjera republikane si: Lidhja Shqiptare, në St. Louis, Organizata Shqiptare në Boston, Klubi Demokratik Shqiptaro-Amerikan në Nju

<sup>3</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: "Toena", 2007, f. 522-526 (pjesë e përgatitur nga F. Rama).

Fatmira Rama, art. "Probleme të pavarësisë dhe të konsolidimit të shtetit shqiptar në debatin politik në emigracionin shqiptar (1925-1939)", në librin *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfida të shtetit shqiptar gjatë shek.XX*, Tiranë: Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë, 2007, f.300-315.

Jork, apo "Komiteti Nacional Republikan" (Këmisha Bardhë e Zi), në Boston, e shpallur ilegale, republikane dhe revolucionare<sup>4</sup>.

Në këtë kontekst vazhdoi polemika mes dy grupimeve, e cila ishte sa interesante, aq edhe e ashpër, e tejzgjatur. Ajo megjithëse u zbeh, nuk pushoi as me shkrirjen e akujve mes Nolit dhe Zogut, mes Nolit dhe Konicës, nga fundi i vitit 1933, fillimi i vitit 1934, në rrethana të pasqyruara gjerësisht, ndër të tjera, në librin e Nasho Jorgaqit, "Jeta e F.S.Nolit"<sup>5</sup>. Mendojmë se, ky hap nga ana e Nolit, nuk mund të ishte thjesht rrjedhojë e gjendjes së rënduar fizike dhe financiare të tij, por diçka më tepër. Ai shprehte mbase edhe pranimin e një realiteti të ri nga ana e tij, të hapave të hedhur për ndërtimin e shtetit shqiptar, por dhe zhgënjimet nga konfuzioni, dhe në disa raste, nga degradimi i disa segmenteve të emigracionit politik shqiptar. Dashur pa dashur, ky ishte një gjest, edhe për evitimin e përçarjes në gjirin e Federatës "Vatra" të shqiptarëve të Amerikës dhe më tej.

Në këtë kontekst, nuk qëndron aspak ndonjë deklaram i bashkëkohësve të Nolit (Peter Minnor etj.), cituar edhe në ndonjë organ të shtypit bashkëkohor shqiptar. Sipas tij, që mbas këtij hapi Noli do të merrte një pension të përmuajshëm nga Konsullata Italiane, me kusht që të qëndronte i pavarur në politikën shqiptaro-italiane<sup>6</sup>. Informacionet e Konsullatës Italiane në SHBA, që ndiqnin hap pas hapi zhvillimet në mjediset shqiptaro-amerikane, "Vatrën" dhe liderët e tyre, nuk lënë asnjë dyshim për këtë. Ata shprehnin qartë pamundësinë për të tërhequr Nolin në politikën italiane dhe informonin për "raportet jo pak interesante" dhe "kontaktet e ngushta në këto vite Noli-Konica"<sup>7</sup>.

Emigrantët shqiptarë u bënë thirrje për evitimin e përçarjeve dhe rigjallërimin e kësaj organizate, e quajtur "simbol i shqiptarizmit" në SHBA e në krejt diasporën shqiptare. Që në prag të shpalljes së Monarkisë, Kuvendi i XVII i "Vatrës", në korrik 1928, i quajtur "Kuvendi i Bashkimit", konstatoi se kjo organizatë po kalonte krizën më të madhe. U vendos që të pranoheshin të përjashtuarit, por vetëm ata që ishin penduar dhe i bindeshin Kanunores së saj. Por ky qëndrim veçse sa e zbuti paksa situatën.

Në këtë frymë, në Kuvendin e XX të "Vatrës", në qershor 1935, u reduktuan nenet përjashtuese dhe u vendos të shpallej një amnisti e përgjithshme, të disa personave të njohur dhe me aktivitet të spikatur dhe të ftohej Noli të vinte në Kuvend. Kjo nuk u realizua, për arsye të qëndrimeve të tij neutrale, të shpallura tashmë. Në vazhdë të tij, në 26 tetor 1935 u thirr Kongresi i Jashtëzakonshëm i "Vatrës" dhe u lëshua thirrja "Rreth Vatrës".

<sup>4</sup> *AQSh*, Fondi 847, viti 1936, dos. 238, fl.1; Nasho Jorgaqi, *Jeta e F.S. Nolit*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Onufri", "GVA", f. 109-110, 133, 153.

<sup>5</sup> N. Jorgaqi, *vep. e përzm.*, f. 136-139.

<sup>6</sup> S. Balla, "F. S. Noli", artikull në rev. *Klan*, dt. 31 janar 1999.

<sup>7</sup> *AQSh*, Fondi 261, viti 1940, dos. 654, fl.1-4.

Gazeta "Dielli" në nëntor 1935 pohonte qartë se, "grindjet politike, përçarjet dhe ambiciet personale kanë një kohë mjaft të gjatë që po vazhdojnë mes shqiptarëve të Amerikës". "Që kur nisnë përçarjet politike, - vazhdonte gazeta, - ju bë mjaft dëm i madh "Vatrës" me heqjen e shumë anëtarëve me mendime politike të ndryshme..., na duket se tani është koha të harrojmë të shkuarat dhe të mblidhemi të gjithë tok rreth Federatës "Vatra"<sup>8</sup>.

Por, më tepër se politizimi i saj, tashmë ishin politikat personale të drejtuesve dhe përpjekjet për instrumentalizimin e saj, që çuan në mbylljen e "Vatrës" më 14 janar 1936 dhe funksionimin më pas të dy organizatave të "Vatrës", të dy gazetave "Dielli", me qendër në Detroit dhe në Boston. Me të drejtë gazeta "Dielli" në Boston theksonte në analizat e saj se, "Vatra" nuk u pengua nga kriza ekonomike, "se sa nga ajo politike", se "përçarjet dhe grindjet nuk kishin qenë veçse ndryshime mendimesh politike", se "Vatra" ishte bërë viktimë e politikave personale"<sup>9</sup>.

Këto politika personale, kishin shkuar tepër larg, edhe tej politikave të shtetit shqiptar për diasporën shqiptare dhe e shqetësuan qeverinë shqiptare. Ajo dërgoi në mars 1937 në Detroit dhe në Boston Aqif Pashë Përmetin dhe Kristo Kirkën, me mesazhin e bashkimit. Këtij mesazhi do t'i shërbente dhe vizita e tre motrave të Zogut në kolonitë shqiptare në SHBA, në shkurt-mars 1938, të shoqëruara kudo nga Faik Konica. Në jo pak raste, shoqëruesit e tyre zyrtarë, shprehën dhe një herë dëshirën, që të dy "Vatrat" të bashkoheshin me qendër në Boston. Por megjithë takimet midis tyre dhe Kuvendin e Përbashkët, në 24 prill 1937 në Boston, kjo nuk u arrit veçse mbas pushtimit të Shqipërisë<sup>10</sup>.

Megjithëse jo një dukuri thelbësore, edhe në vitet e Monarkisë, u vu re tendenca e interferimeve dhe spekulimeve fetare e krahinore në luftën politike. Është fakt i njohur, që themeluesit e nacionalizmit shqiptar, ta kërkonin identitetin fetar tek gjuha dhe traditat shqiptare, përderisa "feja dhe shumëçka tjetër në Shqipëri ishte më shumë faktor ndarës se sa unifikues"<sup>11</sup>.

Shumë historianë, vizitorë, analistë shqiptarë dhe të huaj e kanë përcaktuar këtë si një prirje moderne shqiptare, kur ata (shqiptarët) kishin zgjedhur të ndiheshin si komb në fillim e pastaj të identifikoheshin si identitet fetar.

Por, pa i lëvizur asnjë presje këtyre konstatimeve, është vënë në dukje gjithashtu se, shteti i ri shqiptar do të ngrihej e konsolidohej, duke përballuar një sërë sfidash, ndër të cilat dhe realitetin e ndarjes në katër besime fetare, që

<sup>8</sup> Shënimi editorial: "Rreth "Vatrës"", gazeta *Dielli*, dt. 15 nëntor 1935.

<sup>9</sup> "Rilindja e "Vatrës", gazeta *Dielli*, Detroit, dt. 15 janar 1937.

<sup>10</sup> F. Ch. Panariti, "Sot na duhet një bashkim i përgjithshëm", gazeta *Dielli*, Detroit, nr. 5458, dt. 14 prill 1939.

<sup>11</sup> Erik Hobsbaum, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780*, Tiranë: "Toena", 1996, f.53.

është quajtur nga një sërë historianësh dhe analistësh "si pengesa më e madhe"<sup>12</sup>. Pikërisht përballja me një sfidë të tillë në diasporën shqiptare në vitet e monarkisë, do të jetë një objekt tjetër i parashtrësës sonë, sigurisht duke u përqendruar në disa aspekte, pa e rrokur atë në të gjithë kompleksitetin e saj.

Në vazhden e viteve 1925-1928, një ndër shkaqet, që thelluan krizën e Federatës "Vatra", të trajtuar më lart, ishte edhe një tendencë për të manipuluar ndjenjat fetare të emigrantëve shqiptarë në SHBA dhe më tej, në këtë rast të myslimanëve. Jo si politikë zyrtare e "Vatrës", por rrjedhojë e politikës personale të disa elementëve me ndikim në kryesinë e "Vatrës". Në kuadrin e shprehjes së lirë të mendimeve në gazetën "Dielli", apo të spekulimit me këtë standart të realizuar në faqet e saj, u hodhën edhe ide që i trajtuan muhamedanët si themeli i "Vatrës" dhe i qëndrimeve të drejta në dobi të shtetit shqiptar, madje dhe në një sërë shkrimesh editoriale dhe në rubrikën "Shtylla" të Faik Konicës.

Në nëntor 1930 kjo gazetë, në artikullin e saj redaksional, shprehte mendimin se, Noli që kur shkeli në Amerikë, "e deklaroi luftën me anë të kishave shqiptare". Atje pohohej se, kishat shqiptare në të kaluarën kishin luajtur rol për çështjen kombëtare. "Por për fat të keq, - vazhdonte artikulli, - janë zaptuar prej Nolit..., që i ka bërë fole të propagandës në dëm të Shqipërisë"<sup>13</sup>.

Një sërë artikujsh filluan të vinin në shënjestër personalitete të jetës politike e shtetërore në Shqipëri, si Koço Kottën etj. Krahas anëve negative, ata e sulmuan atë për të kaluarën, duke e cilësuar si "grekoman e kryeandart"<sup>14</sup>. Njëkohësisht "Dielli" filloi të botonte pjesë të tëra të librit "O Vorio Ipiritiko Agon" ("Lufta e Vorio-Epirit"), për të ashtuquajturën "Lëvizje Vorio-Epirote" në vitet 1913, 1914, shkruar e botuar në Greqi, ku përmendeshin edhe elementë fanatikë ortodoksë shqiptarë, si pjesëmarrës në bandat andarte<sup>15</sup>.

Për një kohë pak a shumë të gjatë, në gjysmën e parë të viteve 30, gazeta "Dielli" dhe Faik Konica, zhvilluan një polemikë të ashpër me gazetën "Shqipëria e Re" në Kostancë të Rumanisë, e cila që në këtë periudhë kishte kaluar në qëndrime kritike ndaj politikave qeveritare të Tiranës. "Dielli" arriti deri atje, sa të theksonte se, "lëvizja kombëtare në Rumani u çduk krejt", se

<sup>12</sup> Dorian Koçi, "Rrugëtimi i identitetit fetar", gazeta *Shekulli*, dt. 11 nëntor 2007.

<sup>13</sup> Shënimi editorial: "Lidheni të prishurin mendsh", gazeta *Dielli*, Boston, dt. 4 nëntor 1930.

<sup>14</sup> Gjonaliu, "Don Kishoti i Mançes niset për luftë", gazeta *Liria Kombëtare*, dt. 25 shtator 1930.

<sup>15</sup> Shënimi editorial: "Lufta nënë dhe", gazeta *Dielli*, dt. 12 qershor 1931.

shqiptarët e Kostancës ishin "disa stanarë dhe armiq të kombit", se në Rumani s'kishte më koloni shqiptare "me ndjenja kombëtare"<sup>16</sup>.

Kjo fushatë, që mori shpeshherë një karakter të hidhur dhe përçarës, ngjalli një reaksion të madh kudo. Në gazetën "Republika" në Boston, Sejfulla Malëshova me pseudonimin Lame Kodra, tërhiqte vëmendjen nga Parisi se, "Dielli" s'bënte mirë që përkthente dhe botonte pjesë të librave të tillë përçarës<sup>17</sup>. Vetë komuniteti shqiptar në SHBA dhe në mbarë diasporën shqiptare kundërveproi ashpër, madje me shumë artikuj kritikë ndaj kësaj tendence, të botuara po në faqet e gazetës "Dielli" dhe të tjera. Kryesia e "Vatrës" u ndal disa herë në këtë dukuri dhe mori vendime, që "Dielli" të mos lejonte botimin e artikujve të tillë. Edhe autoritetet shqiptare, në disa raste, e ndaluan "Diellin" të hynte në Shqipëri dhe pezulluan për ca kohë mbështetjen financiare ndaj saj, që shteti shqiptar e kryente prej kohësh.

Një frymë e tillë, për të manipuluar ndjenjat fetare të emigrantëve shqiptarë në dobi të politikës së ditës, u vu edhe në disa segmente të mërgatës politike, të cilët në kuadër të shpalljes së Monarkisë dhe mbas saj, synuan të ngrinin një të ashtuquajtur "Lëvizje Kristiane". Në krye të kësaj veprimtarie qëndronte Koço Tassi, ish deputet, politikan, pjesëmarrës në Lëvizjen e Qershorit 1924, tashmë emigrant politik në Athinë dhe Dom Loro Caka, edhe ky emigrant në Jugosllavi, prift katolik, drejtues i Kryengritjes së Dukagjinit, në nëntor 1926. Pjesa kristiane e emigrantëve politikë në Jugosllavi, pas dështimit të Kryengritjes së Dukagjinit dhe largimit nga organizata "Bashkimi Kombëtar", formuan nga fundi i vitit 1927 organizatën "Lekë Dukagjini", që mbase mund të jetë e para organizatë politike shqiptare në emigracion, mbas krijimit të shtetit shqiptar, mbi baza kristiane<sup>18</sup>.

Koço Tasi dhe Dom Loro Caka, drejtues të Lidhjes së Emigrantëve në Jugosllavi, në këtë periudhë, në prag dhe pas shpalljes së Monarkisë (1928,1939) proklamuan një sërë letrash e broshurash, të shpërndara në emigracionin shqiptar. Ja disa nga titujt e broshurave të Koço Tassit: "Tradhëtia dhe pabesia e dytë e myslimanëve", Athinë, 1929; "Shqiptarëve të krishterë, bashkëpunëtorëve të muhamedanëve", 1929, Athinë; "Kush e ka fajin", Athinë, 1929 etj. Ja dhe titujt e broshurave jo të pakta të Dom Loro Cakës, botuar në Vjenë, kryesisht gjatë vitit 1929: "Ç'janë muhamedanët", "Kush e fiku Shqipërinë", "Kush janë tradhëtarët", "Kush është Bashkimi Kombëtar" etj<sup>19</sup>.

Materialet në vija themelore janë në të njëjtat shina: u shprehën kundër shpalljes së Monarkisë Shqiptare, kritikuan regjimin e Zogut, u shprehën

<sup>16</sup> Gjonaliu, "Don Kishoti i Maçes niset për luftë", gazeta *Liria Kombëtare*, dt. 25 shtator 1930; "Kolonja e stanarëve", gazeta *Dielli*, dt. 27 korrik 1934.

<sup>17</sup> "Lame Kodra", gazeta *Dielli*, dt. 8 prill 1932.

<sup>18</sup> *AQSh*, Fondi 847, viti 1929, dos. 279, fl. 90/1.

<sup>19</sup> *Po aty*.

kundër depërtimit italian në Shqipëri, kërkuan liri dhe të drejta konstitucionale për të gjithë qytetarët etj.<sup>20</sup> Këto kërkesa, në thelb ishin pothuajse të njëjta në gjithë mërgatën politike dhe organizatat e njohura si: të KÇN, Bashkimit Kombëtar etj. Por në veçanti, krahas thirrjeve drejtuar gjithë shqiptarëve, ata iu drejtuan të krishterëve shqiptarë, pas akuzave drejtuar myslimanëve për "tradhëti" e bashkëpunim me Portën e Lartë Osmane. Sipas tyre, me shpalljen e Monarkisë dhe proklamimin e Zogut Mbret, u krye tradhtia e dytë ndaj tyre. "Ushtrimi i sovranitetit kombëtar, - theksohej në një nga këto materiale, - u bë vetëm një privilegj i muhamedanëve". Në to akuzohej se, ishin shkelur parimet e Konstitucionit të Lushnjës (Statutit të Lushnjës), që garantonte barazi për të gjithë qytetarët, pa dallim feje, se ishte reduktuar numri i kristianëve në administratë, se ata po shtypeshin dhe ekonomikisht etj. Ata u ndalën në Statutin e Lushnjës, i cili kishte vendosur disa garanci të tilla përfaqësimi proporcional, për kategoritë e ndryshme fetare në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv, besuar një Këshilli të Regjencës me katër anëtarë: dy myslimanë, një katolik dhe një ortodoks.

Me shpalljen e Monarkisë, sipas këtij parashtrimi, ishte reduktuar numri i funksionarëve kristianë në proporcion 10%, çka trajtohej si inferiore, në raport me proporcionet reale të kësaj popullsie. Po sipas kësaj llogjike, ushtrimi i sovranitetit kombëtar tashmë ishte bërë vetëm "privilegj i muhamedanëve" dhe "islami ishte bërë një fe shtetërore"<sup>21</sup>.

Pa pasur mundësi të paraqesim përqindjet e zyrtarëve në administratën shqiptare, sipas përkatësisë fetare, deshëm të vemë në dukje se ky lloj arsyetimi ishte spekulativ, kur me shpalljen e Republikës në mars 1925 u miratua përfundimisht Kushtetuta Republikane, që kishte zëvendësuar Statutin e Lushnjës dhe Statutin e Zgjeruar të Lushnjës. Si kjo kushtetutë dhe Kushtetuta e Monarkisë, miratuar në dhjetor 1928, në vazhdë të legjislacionit të mëparshëm, shpallën laicitetin e shtetit shqiptar, lirinë e besimit dhe të drejtën e të gjithë qytetarëve pa përjashtim përballë ligjit<sup>22</sup>.

Në këto letra e proklamata u vlerësuan Lëvizja e Mirditës në qershor-korrik 1921 dhe Kryengritja e Dukagjinit, nëntor 1926, të cilësuar në historiografinë shqiptare dhe më tej si separatiste dhe me nuancime fetare. Dom Loro Caka, ndërsa dënonte aleancën italo-shqiptare, shprehte kërkesën për marrëveshje politike dhe ekonomike me shtetin jugosllav, "pa fye të drejtat tokësore". Njëkohësisht ata u bënë thirrje elementëve të krishterë në emigracion

<sup>20</sup> *Po aty*, Fondi 847, viti 1922, dos. 279, fl. 8-40.

<sup>21</sup> *Po aty*.

<sup>22</sup> Aurela Anastasi, *Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Luarasi", 1998, shih f. 255-269; *Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare*, Tiranë: Zyra e Shtypit e Oborrit Mbretëror, 1997, f. 3.

për mobilizimin e tyre dhe krijimin e organizatave, qoftë dhe me tre vetë, për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Të tërheq vëmendjen fakti se, këto grupime a individë, u shprehën kundër Statutit dhe Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale dhe martesës civile, sipas Kodit të ri Civil, vënë në zbatim në prill 1929, i cili garantonte njëkohësisht kurorëzimin e elementeve të besimeve të ndryshme fetare<sup>23</sup>.

Pikërisht në këtë periudhë, pas krijimit të shoqërisë së emigrantëve politikë kristianë në Jugosllavi "Lekë Dukagjini", ka të dhëna të takimeve të emigrantëve politikë të ndonjë grupimi në Jugosllavi e Greqi, me elementë shqiptarë kristiane në Egjipt, Paris etj. dhe krijimin e dy shoqërive kristiane: "Shoqëria e Miqve" në Kajro në maj 1928 dhe shoqëria "Gjin Bue Shpata" në Paris, në shtator 1928. Programet e tyre ishin: për "mbrojtjen e indipendencës shqiptare dhe shpëtimin e vendit nga ndërhyrjet e huaja", "për drejtësi e njëhësi midis elementeve fetarë në Shqipëri" dhe "zhvillimin e ndjenjës vëllazërore midis shqiptarëve të mërguar"<sup>24</sup>. Të dhëna dokumentare, jo aq të konfirmuara, flasin dhe për krijimin e ndonjë shoqate tjetër kristiane në këto dy vende, por që si duket, mbetën më shumë hipotetike.

Të bën përshtypje lëvizja intensive në disa segmente shqiptare kristiane në Egjipt. Pjesërisht kjo gjen përgjigje në situatën e vështirë, në të cilën u gjendën shqiptarët atje, për pajisjen e tyre me dokumente nga ambasada shqiptare. Kjo ishte e domosdoshme për të përfituar nga kapitulationet e njohura për të huajt në këtë vend, që dëmtonte sidomos tregtarët, financierët etj., që në shumicë u përkisnin të krishterëve. Në këto situata konsullatat greke në Egjipt gjallëruan aktivitetin e tyre, për pajisjen e shqiptarëve me pashaporta greke, shoqëruar edhe me tentativa për manipulimin e tyre etnik dhe politik.

Këto shoqata kristiane dërguan letra të veçanta në Lidhjen e Kombeve. Kështu në një thirrje të shoqërisë "Gjin Shpata" në Paris, më 17 qershor 1928, dhe në një letër drejtuar sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve Erik Drummond, në shtator 1928, parashtroheshin pothuajse të njëjtat çështje të trajtuara në letrat e proklamatat e mësipërme dhe kërkohej që Lidhja të ndërhynte për të siguruar, sipas tyre, "liritë e kërcënuara të kristianëve"<sup>25</sup>.

Në këto lëvizje, në veçanti të tërheq vëmendjen fakti se, Grupi i Gjakovës me emigrantë politikë, kryesisht muhamedanë, por edhe të krishterë, kishte vendosur të hynte në Lidhjen e Emigrantëve Jugosllavë, që në mars 1927, të bashkëpunonte me organizatën politike kristiane "Lekë Dukagjini". Më 22 qershor 1929 pjesa muhamedane e këtij grupimi lëshoi një deklaratë, në furinë e deklaratave, proklamatave, thirrjeve nga disa palë e në debate midis

<sup>23</sup> AQSh, Fondi 847, viti 1929, dos. 279, fl. 8-40.

<sup>24</sup> Po aty, Fondi 251, viti 1930, dos. 158, fl. 57; "Lëvizja kombëtare në koloni të Misirit", gazeta *Bashkimi*, nr. 10, dt. 18 maj 1928.

<sup>25</sup> AQSh, Fondi 847, viti 1929, dos. 279, fl.1, 2, 6, 7.

tyre, të emërtuar "Deklarata e emigrantëve muhamedanë të bajraqeve Has, Bytyç, Gash e një pjesë të Krasniqes, të ndodhur në Gjakovë". Sipas saj, të krishterët kishin të drejtë në kritikën e tyre ndaj regjimit dhe "invazionit të huaj", se nuk kishin pretenduar dhe as pretendonin hegjemoni por barazi dhe të drejta proporcionale midis elementeve fetarë, se popullsia muhamedane nuk ishte për shtypjen e pakicës<sup>26</sup>.

Ky qëndrim i bajraktarëve në emigracion mendojmë se, buronte sa nga bashkëpunimi në shekuj me bashkëkombasit kristianë, aq edhe nga fakti i njohur se, bajraktarët ndonëse në shumicën e rasteve i kishin dhënë besën Zogut, "nuk kishin bërë kurrfarë betimi se do të mbështesnin Zogun mbret"<sup>27</sup>. Gjithashtu, në kushte të vështira të mbijetesës në emigracion ata aderuan, siç thamë më lart, në Lidhjen e Emigrantëve në Jugosllavi, dhe adaptuan politikën e saj të diktuar në këtë rast edhe nga Beogradi, i cili i mbështeste ata financiarisht.

Mund të shtrohet pyetja: Pse pikërisht në këtë periudhë: 1928, 1929, u vu re një lloj "lëvizjeje kristiane" në emigracionin politik dhe në diasporën shqiptare; sa ajo përfaqësonte realisht masën e popullsisë së krishterë në Shqipëri dhe a pati një bazë reale. Duke nisur nga pyetja e fundit, sipas profesor Sederholm, dërguar në Shqipëri nga Lidhja e Kombeve në vitet 1922-1923, dallimet ndërfaqetare ishin më shumë "çështje klase, çështje sociale", kur të parët (muhamedanët) ishin pronarë tokash dhe zyrtarë dhe kur mbas luftës së gjatë për liri e pavarësi, në bashkëpunim me muhamedanët, të krishterët kërkonin me të drejtë një pozitë politike e sociale të barabartë me të gjithë, krahas të gjithë shtresave të shoqërisë shqiptare<sup>28</sup>.

Në këtë kontekst, është e natyrshme, që në përplasjet politike e sociale në shtetin e ri shqiptar të shfaqeshin dhe kërkesa të tilla, më se realiste. Mbase këtu qëndronte ajo bazë reale ku gjetën terren në disa raste këto thirrje dhe proklamata përçarëse në kuadrin e luftës politike për përmbysjen e regjimit dhe të monarkisë zogiste.

Por nuk mund të mos vëresh, që kjo lëvizje u intensifikua pikërisht në vitin 1929, kur edhe u krijua Sinodi i Shenjtë i Kishës Autoqefale Shqiptare dhe u zhvillua Kongresi i Dytë i saj në Korçë më 16 qershor të atij viti, që shkaktoi një reagim të papërmbytur të Patriarkanës, të kishës greke, të sillogjeve vorio-epirote dhe vetë shtetit grek. Prej tyre këto hapa u quajtën kërcënim direkt i interesave të popullsisë ortodokse në Shqipëri, si grusht shteti shqiptar dhe u organizuan demonstrata antishqiptare para ambasadave të huaja dhe asaj

<sup>26</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>27</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë, 1912-2000*, Tiranë: "Shtëpia Botuese e Librit Universitar", 2007, f. 175.

<sup>28</sup> Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Dituria", 2005, f. 322, 323.

shqiptare në Athinë, të shoqëruara me një fushatë të egër publicistike në Greqi dhe jashtë saj, me letra në Lidhjen e Kombeve etj.<sup>29</sup> Kjo të çon në konkluzionin se mbrapa protestave të tilla, në mënyrë të kamufluar mund të qëndronin edhe qarqe të tilla shovene, greko-jugosllave.

Në mars 1929, Kryekonsullata Shqiptare në Janinë informonte se Koço Tassi, emigrant politik, kishte mbërritur në Janinë për të reformuar "Klubin Vorio-Epirot" të Janinës. Ajo shprehte mendimin se, ky hap mund të kishte lidhje me shpalljen e autoqefalisë së Kishës Kombëtare Shqiptare. Për të kuptuar qëllimin e kësaj vizite, të arraturit politikë të Korfuzit, kishin dërguar një njeriun e tyre në Athinë<sup>30</sup>. Në qershor 1929, sipas një raporti tjetër nga nënprefektura e Çamërisë në Konispol, ky person "po zhvillonte një luftë me elementin mysliman shqiptar, në përpjekje për të arritur marrëveshje me të krishterët e Gjirokastrës"<sup>31</sup>.

Kjo ofensivë politike, me petk agresiv fetar, gjeti kundërshtim në masën e gjerë të diasporës shqiptare dhe në gjithë spektrin politik të organizatave politike të emigrantëve si: në Vjenë, Itali, SHBA etj. Në këtë rast këto organizata ishin në unison me politikën zyrtare të Tiranës. Shtypi shqiptar në emigracion i emërtoi këta elementë si "aventurierë politikë" dhe "vagabondë internacionalë", që fenë e përdornin për ambicie politike. Organizata "Bashkimi Kombëtar", zhvilloi një debat të ashpër dhe u distancau prej tyre, dikur anëtarë të "Bashkimit Kombëtar", duke i gjykuar këto deklarata në kundërshtim me Rregulloren dhe principet e saj. Ajo u shpreh qartë se, nuk ishte kundër organizatave të krishtera, "deri sa ato i mbeteshin besnike programeve të shprehura"; se i respektonte ato, por jo përçarjen fetare<sup>32</sup>. Përfaqësuesi konsullor në Vjenë informonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë në mars 1929 se, "ishin fare të paktë ata shqiptarë që simpatizonin Koço Tassin...", "se këto idera s'kanë bërë një përshtypje të mirë në qark të emigracionit tonë, këto pa ndryshim partije".

Në Paris u themelua ndërkohë një shoqëri e re, "Zemra Shqiptare", nga një grup të rinjsh. Në një thirrje të saj drejtuar të gjithë patriotëve shqiptarë ajo informonte për persona, që nën maskën e patriotizmit, shëtinin nëpër kolonitë e jashtme. Sipas Thirrjes ata helmonin zemrat e emigrantëve "me fanatizmin e keqe", duke iu adresuar edhe disa anëtarëve të shoqërisë së krishterë të Misirit, që emërtoheshin "vegla të verbëra të të famëshme sillogje".

<sup>29</sup> Fatmira Rama, "Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i Dytë Panortodoks i Kishës Autoqefale Kombëtare", në librin *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale*, Tiranë: Akademia e Shkencave, 1993, f. 66.

<sup>30</sup> *AQSh*, Fondi 251, viti 1929, dos. 588, fl. 2, 3.

<sup>31</sup> *Po aty*, fl. 32, 33.

<sup>32</sup> *Gazeta Bashkimi Kombëtar*, nr. 25, dt. 12 tetor 1928; *po aty*, nr. 27, dt. 2.11.1928.

Në Thirrje theksohej se, kjo organizatë ishte e larguar nga çdo influencë fetare, se qëllimi i saj ishte të luftonte rreptësisht çdo shoqëri ose propagandë që ndante shqiptarët. Ajo mbyllej me fjalët e vjershëtorit Vaso Pasha: "Edhe mos shikoni kisha e xhamija, se fe e shqiptarit asht shqiptarija", çka shprehte esencën e identitetit real shqiptar<sup>33</sup>.

Kjo lëvizje në diasporën shqiptare u zbeh shpejt. Organizatat e sipërpërmendura dhe thirrjet e tyre nuk u ndjenë më pas vitit 1929 dhe kjo lëvizje politike me petk fetar kristian nuk gjeti terren. Ndërkohë në SHBA, gazeta "Dielli" apo më saktë, disa artikuj në faqet e saj, vazhduan të spekullonin në luftën politike, por në krah të kundërt, deri nga mesi i viteve 30, por pa gjetur aspak mbështetje të vërtetë në komunitetin shqiptar atje a gjetkë. Por megjithë kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet jo të pakta politike e sociale shqiptarët në diasporë, si një gjymtyrë e kombit shqiptar, në rrugën e konsolidimit të mëtejshëm të identitetit të tij kombëtar, për mendimin tonë arritën ta përballonin edhe këtë sfidë, së bashku me bashkëpatriotët e tyre në trungun amtar.

---

<sup>33</sup> *AQSh*, Fondi 847, viti 1929, dos. 279, f.3.

